

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes  
së Komisionit Rregulator  
të datës 24.12.2020 ora 17:30*

**Mbledhje e Komisionit Rregulator të KQZ**

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e ylerave materiale e monetare për llogari të zgjedhjeve dhe për qëllime politike të përfituar nga partitë politike po kandidatët gjatë fushatës zgjedhore.*

**PJESËMARRJA:**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI      Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Komisioni Rregulator:**

- |                          |                |
|--------------------------|----------------|
| <b>1. Ilirjana NANO</b>  | <b>Kryetar</b> |
| <b>2. Arens ÇELA</b>     | <b>Anëtar</b>  |
| <b>3. Dritan ÇAKA</b>    | <b>Anëtar</b>  |
| <b>4. Helga VUKAJ</b>    | <b>Anëtar</b>  |
| <b>5. Muharrem ÇAKAJ</b> | <b>Anëtar</b>  |

**Stafi i KQZ:**

- |                       |                                |
|-----------------------|--------------------------------|
| <b>Ylli MERKAJ</b>    | <b>Sekretar i Përgjithshëm</b> |
| <b>Madalena KOJA</b>  | <b>Drejtoria Juridike</b>      |
| <b>Parti Politike</b> | <b>PS, PD, LSI</b>             |

**Zonja Ilirjana Nano:** Mirëmbërëma të nderuar kolegë! Mirë së keni ardhur! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregulator, e cila është vënë në lëvizje pas njoftimit zyrtar nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Është njofuar publikisht media dhe forcat politike. Në mbledhjen e komisionit rregulator janë të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij komisioni; është i pranishëm gjithashtu komisioneri i këtij komisioni, zoti Ilirjan Celibashi; janë të pranishëm përfaqësues të partive politike si dhe zyrtare të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke nisur me sekretarin e përgjithshëm të këtij institucioni. Sikundër



***Procesverbal i zbardhur i mbledhjes  
së Komisionit Rregulator  
të datës 24.12.2020 ora 17:30***

jeni në dijeni kjo mbledhje sot ka një pikë të rendit të ditës; kemi për të shqyrtuar projekt vendimin për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerave materiale e monetare për llogari të zgjedhjeve dhe për qëllime politike të përfituar nga partitë politike po kandidatët gjatë fushatës zgjedhore. Ky akt vjen në kuadër të një numri aktesh që lidhen me financimin e partive politike. Aktin do të na e prezantojë Komisioneri së bashku me relacionin përbledhës. Ndërkohë një njoftim edhe për anëtarët e komisionit rregulator dhe të pranishmit në mbledhje. Pasi të përfundojmë këtë seancë të njoftuar tashmë zyrtarisht për të nisur në 17:30, rikujtoj që seancën e ditës së djeshme e kemi shtyrë, për të përfunduar shqyrtimin e një akti tjetër që nisem dje; pra do të mbyllim këtë seancë me aktin që sapo përmenda, më tej do të vijojmë me aktin e djeshëm. Ftoj në këtë moment zotin Celibashi për të prezantuar aktin; zoti Celibashi fjala është për ju.

**Zoti Ilirjan Celibashi:** Faleminderit dhe mirëmbërëma të gjithëve!

Projekt vendimi për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerave monetare dhe të dhurimeve në natyre ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore është një akt normativ në fushën e rregullimit të këtyre marrëdhënieve nga ana e rregulatorit.

Sipas parashikimeve të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 të kodit zgjedhor, KQZ-ja është e detyruar që të përcaktojë me vendim rregullat dhe modalitetet e nevojshme për llogaritjen e vlerave monetare dhe të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve të dhëna sipas vlerës së tregut në momentin e dhënieve së tyre. Qëllimi i projektvendimi është pikërisht caktimi i këtyre rregullave për llogaritjen e vlerave monetare dhe të dhurimeve në natyrë, të shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes  
së Komisionit Rregullator  
të datës 24.12.2020 ora 17:30*

Projektvendimi jep përkufizimin e dhurimeve në natyrë, duke konsideruar si të tilla dhurimet në formë mallrash, produktesh dhe shërbimesh të ofruara pa pagesë, ose me një çmim më të ulët së ai i tregut; huatë dhe kreditë me përqindje më të ulëta së normat e interesit të tregut ose pa normë interesit fare. Përfituesi dhe dhuruesi duhet të mbajnë dokumentacion i cili vërteton vlerën monetare të dhurimeve në Shqipëri në momentin e dhurimit që përcakton ky akt. Kur një zgjedhës ofron kohën e tij pa pagesë për të ndihmuar fushatën zgjedhore, atëherë veprimtaria e zgjedhësit do të konsiderohet si një veprimtari vullnetare dhe jo dhurim në natyrë në kuadër të veprimtarisë elektorale të subjektit zgjedhor. Dhurimet në natyrë ose shërbimet i nënshtrohen të njëjtave rregulla regjistrimi si ato monetare. Dhurimet në natyrë duhet të raportohen nga subjekti zgjedhor sikurse dhurimet në para dhe duhet të përllogariten në vlerë monetare. Dhurimet në natyrë raportohen si dhuratë në fushatën dhe njëkohësisht si shpenzim i fushatës. Përllogaritja e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë dhe shërbimeve për qëllime zgjedhore ose politike, të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore bëhet në bazë të vlerës së tregut në momentin e dhënies/përfitimit të tyre. Projektvendimi parashikon gjithashtu rastet kur dhurimet ose shërbimet apo mallrat ofrohen pa pagesë ose me çmim më të ulët sesa çmimi i të njëjtave shërbime apo mallra në kushtet e tregut, atëherë diferenca ndërmjet shumës që subjekti zgjedhor do të paguante për mallrat ose shërbimet sipas çmimeve të tregut me shumën që paguan realisht, konsiderohet si dhurim në natyrë. Gjithashtu, projektvendimi parashikon edhe mënyrën së si do të jetë çmimi i tregut për mallra dhe shërbime; dhe konkretisht, ajo do të përcaktohet sipas këtyre rasteve; Në mënyrë të përbledhur:

- Nëse është e mundur, duke iu referuar indeksit mujor të çmimeve, të publikuara nga INSTAT, në kohën kur mallrat/shërbimet janë ofruar;



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes  
së Komisionit Rregulator  
të datës 24.12.2020 ora 17:30*

- Nëse furnitori operon në biznesin e ofrimit të këtyre të mirave dhe shërbimeve, çmimi i tregut do të jetë vlera normale tregtare që aplikon furnitori për to;
- ose, nëse nuk realizohet së pari, metoda e përcaktuar në shkronjë "a" dhe më pas ajo në shkronjën "b" të kësaj pike, subjekti zgjedhor llogarit çmimin e tregut mbi bazën e mesatares së çmimeve të ofruara nga tre ofrues mallrash /shërbimesh të ngjashme. Subjekti zgjedhor kur raporton të ardhurat dhe shpenzimet për veprimtaritë, mallrat apo shërbimet, është i detyruar të referojë dhe dokumentoje metodën e aplikuar për përllogaritjen sipas pikës 11 të këtij vendimi. Një tjetër formë e burimeve të ligjshme të financimit për fushatën zgjedhore janë edhe kreditë dhe huatë. Ky projektvendim është konsultuar dhe ka reflektuar në përbajtjen e tij edhe komente dhe sugjerime të partive politike, si dhe të disa organizatave joftimprurëse të cilat kanë treguar interes më parë. Projekt-vendimi nuk paraqet asnjë kosto shtesë për buxhetin e shtetit; të gjitha shpenzimet në zbatimin e këtij projekt akti do të përballohen nga buxheti i miratuar për komisionin qendror të zgjedhjeve. Ky ishte relaciuni në mënyrë të përbledhur për këtë projektakt. Faleminderit.

**Zonja Ilirjana Nano:** Faleminderit zoti Celibashi. Ftoj kolegët të diskutojnë në parim lidhur me projekt vendimin; dhe më tej edhe përfaqësuesit e partive politike. Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregulator, pyetje apo komente për shtesa e ndryshime?!

Dakord! Nëse kolegët nuk kanë diçka për të thënë, atëherë, unë do të shtoja komentin mbi faktin që ky është projektvendimi i parë që lidhet me financimin e partive politike dhe që vjen për tu shqyrtuar dhe miratuar në KRR-në e KQZ-së.



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes  
së Komisionit Rregulator  
të datës 24.12.2020 ora 17:30*

Kemi edhe disa projekt vendime të tjera të cilat burojnë nga Kodi Zgjedhor, dhe në mënyrë të posaçme nga disa ndryshime që kanë ndodhur në Kodin Zgjedhor, posaçërisht, ndryshimet e Korrikut 2020.

Përfaqësuesit e partive politike kanë diçka për të diskutuar në parim lidhur me projekt vendimin?!

Nëse jo atëherë ftoj kolegët të votojnë në parim projekt vendimin!

Kush është dakord me projekt-vendimin në parim?

**Paneli i anëtarëve të KRR:** Me dorë dhe me zë shprehen Dakord.

**Zonja Ilirjana Nano:** Po, me 5 vota pro miratojmë në parim aktin!

Kalojmë në diskutimin një për një të pikave; janë gjithsej 16 pika të projekt-vendimit.

Mendoni ti lexojmë të gjitha me radhë ato që Komisioneri i përmendi në fjalën e tij?!

**Zonja Helga Vukaj:** Mendoj së është shteruese me aq sa Komisioneri përcollti për ne, kështu që le të vazhdojmë me kalimin e tyre në mënyrë numerike.

**Zonja Ilirjana Nano:** Do të doja që edhe anëtarët e tjerë të KRR-se të shpreheshin nëse do të donin ti kalojmë në mënyrë numerike?!

**Zoti Dritan Çaka:** Unë jam dakord me propozimin!

**Zoti Arenc Çela:** Bashkohem me mendimin e kolegëve!



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes  
së Komisionit Rregullator  
të datës 24.12.2020 ora 17:30*

**Zoti Muharrem Çakaj:** Dakord jam edhe unë!

**Zonja Ilirjana Nano:** Faleminderit zoti Çakaj dhe të gjithë kolegëve parafolës! Atëherë në diskutimin nen për nen, po ju drejtohem së pari përfaqësuesve të partive politike, nëse kanë diçka për të komentuar? ... apo për të propozuar ndonjë shtesë apo ndryshim!

Sigurisht ky nuk është një akt që vjen për herë të parë, por është një akt që diktohet për shkak të ndryshimeve, sikurse theksuam më lart, në takimet e korrikut 2020.

Po zoti Kaso, zoti Kaziaj, zoti Saliani?! Shtesa apo komente?!

**Zoti Ivi Kaso:** Faleminderit zonja kryetare; nuk është së kemi ndonjë gjë konkrete lidhur me aktin; formulimi është korrekt! për sa më përket mua, mund të vazhdojmë!

**Zonja Ilirjana Nano:** Faleminderit!

Zoti Kaziaj?

**Zoti Altin Kaziaj:** Edhe nga ana jonë nuk kemi ndonjë sugjerim konkret dhe mund të vazhdojmë!

**Zonja Ilirjana Nano:** Faleminderit!

Zoti Saliani? Nëse keni ndonjë koment!

**Zoti Eridian Saliani:** Dakord me kolegët parafolës; mendoj të vazhdojmë!



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Faleminderit! Zoti Salianji!

**Z.I.Salianji(Përfaqësues i Partisë Socialiste):** Dakord si kolegët, të vazhdojë miratimin e aktit.

**Znj.I.Nano:** Ok, Faleminderit! Atëherë po kaloj në votimin. Duke nisur nga pika 1. Atëherë në kuptim të këtij vendimi dhurimet në natyrë janë dhurimet në formë mallrash, produktesh dhe shërbimesh të ofruara pa pagesë ose me një cmim më të ulët se ai i tregut, huatë dhe kreditë me përqindje më të ulët se norma e interesit të tregut ose pa normë interesë.

**Kush është dakord në tërësi me këtë formulim?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

**Znj.I.Nano:** Pika 2. Vlera monetare e dhurimeve vërtetohet nga dokumentacioni i mbajtur nga përfituesi dhe dhururei në momentin e dhurimit.

Votojmë pikën 2.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Me 5 vota pro miratohet edhe pika 2.

Pika 3. Kur një zgjedhës ofron kohën e tij/ të saj pa pagesë për të ndihmuar fushatën zgjedhore, atëherë veprimtaria e zgjedhësit do të quhet veprimtari vullnetare dhe jo dhurim në natyrë të veprimtarisë së subjektit zgjedhor.

**Kush është dakord ju lutem me këtë formulim?**

*Zbardhi materialin e incizuar  
Romina Kokoshi*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.24.12.2020*

**Pro:** *5 (z.nj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.nj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Pika 4 e projektvendimit, dhurimet në natyë përfshijnë cdo lloj të ardhure që nuk merret në formë monetare por në natyrë në formë mallrash produktesh dhe shërbimesh. Votojmë formulimin e pikës 4.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5 (z.nj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.nj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Faleminderit Me 5 vota pro miratohet pika 4.

Pika 5. Dhurimet në natyre ose shërbimet i nënshtrohen të njëjtave rregulla regjistrimi si ato monetare. Votojmë pikën 5 ju lutem.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5 (z.nj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.nj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Pika 6. Dhurimet në natyrë duhet të raportohen nga subjekti zgjedhor sikurse dhe dhurimet në para dhe duhet të përllogariten në vlerë monetare. Vlera monetare e tyre llogaritet sips mënyrës së përcaktuar në këtë vendim. Votojmë pikën 6 ju lutem.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5 (z.nj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.nj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar*  
*Romina Kokoshi*



**Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së**  
**Komisioni Rregulator**  
**Dt.24.12.2020**

Pika 7. Dhurimet në natyrë raportohen si dhuratë në fushatë dhe njëkohësisht si shpenzim i fushatës. Votojme pikën 7 ju lutem.

**Kush është pro këtij formulimi?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Pika 8. Përllogaritja e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë dhe shërbimeve për qëllime zgjedhore ose politike të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore bëhet në bazë të vlerës së tregut, në momentin e dhënies së përfitimit të tyre.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Pika 9. Në rastet kur dhurimet ose shërbimet apo mallrat ofrohen pa pagesë ose me çmim më të ulët sesa çmimi i të njëjtave shërbime apo mallra në kushtet e tregut atëherë diferenca mes shumës që subjekti zgjedhor do të paguante për mallrat ose shërbimet sipas çmimeve të tregut me shumën që paguan realisht, konsiderohet si dhurim në natyrë. Votojmë pikën 9 ju lutem.

**Kush është dakord?**


**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Kalojmë në pikën 10. Çmimi i tregut për mallrat dhe shërbimet do të përcaktohet me një nga metodat e mëposhtme:

**Zbardhi materialin e inçizuar**  
**Romina Kokoshi**



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.24.12.2020*

- a. Nëse është e mundur duke iu referuar indeksit mujor të çmimeve të publikuara nga INSTAT, në kohën kur mallrat apo shërbimet janë ofruar.
  - b. Nëse furnitori operon në biznesin e ofrimit të këtyre të mirave dhe të shërbimeve, çmimi i tregut do të jetë vlera normale tregtare që aplikon furnitori për to, ose
  - c. Nëse nuk realizohet së pari metoda e përcaktuar në shkronjën a dhe më pas ajo në shkronjën b të kësaj pike, subjekti zgjedhor llogarit çmimin e tregut mbi bazën e mesatares së çmimëve të ofruara nga 3 ofrues mallrash shërbimesh të ngjashme.
- Votojmë pikën 10.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. Nano, z. Cela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Pika 11. Subjekti zgjedhor kur raporton të ardhurat dhe shpenzimet për veprimtaritë, mallrat apo shërbimet është i detyruar të referojë dhe dokumentojë metodën e aplikuar për përllogaritjen sipas pikës 11 të këtij vendimi. Aplikimi i metodës së përllogaritjes jepet në shembujt sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat paraqiten për qëllime ilustrimi dhe nuk janë shteruese. Votojmë për pikën 11.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. Nano, z. Cela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Pika 12. Kreditë, huatë janë një formë tjeter e burimit të ligjshëm të financimit për fushatën zgjedhore. Kreditë do të llogariten përkundrejt tavanit të dhurimit prej 1 milion lekë. Kushtet e kontratës së kredisë do ti nënshtrohen auditimit si çdo burim

*Zbardhi materialin e incizuar*  
*Romina Kokoshi*



***Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së***  
***Komisioni Rregulator***  
***Dt.24.12.2020***

tjetër financimi pér çdo subjekt politik, subjekt zgjedhor. Votojmë pikën 12 të projektvëndimit.

***Kush është dakord?***

**Pro:** *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Pika 13. Diferenca ndërmjet shumës që subjekti zgjedhor do paguante me normën e interesit të tregut pér shumën e marrë me kredi ose hua me shumën që do të paguajë me normën e interesit që ka marrë realisht, konsiderohet si dhurim në natyrë. Votojmë edhe pikën 13.

***Kush është dakord?***

**Pro:** *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet pika 13!

Dhe vijmë në 3 pikat e fundit. Njëra ka të bëjë me shfuqizimin e Udhëzimit numër 3, datë 02.06.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pér mënyrën e llogaritjes së kostos financiare të veprimeve, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren pér qëllime zgjedhore ose politike nga parti politike gjatë fushatës zgjedhore.

***Kush është dakord me shfuqizimin e udhëzimit të mëparshëm që ka rregulluar këtë vëprimtari?***

**Pro:** *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Pika 15. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi dhe pika 16 po i votojmë të dyja. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen

***Zbardhi materialin e inçizuar***  
***Romina Kokoshi***



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

zyrtare të Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve. Kolegë, kush është dakord me pikën 15 dhe 16.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Faleminderit. Është momenti të votojmë aktin në tërësi projekt vendimin në tërësi.

**Kush është dakord me projektvendimin e paraqitur mbasi e kemi votuar në parim dhe për çdo pikë të tij, në tërësi e votojmë?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Miratohet!

Faleminderit. Të nderuar kolegë, apo kemi miratuar vendimin për miratimin e rregullave dhe modaliteteve për llogaritjen e vlerës monetare të dhurimeve në natyrë ose shërbimeve, huave dhe kredive për qëllime zgjedhore ose politike, të përfituar nga partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatës zgjedhore. Më lejoni që këtë mbledhje publike ta deklaroj të myllur, të marrim vetëm dy minuta pushim dhe të riçelim mbledhjen që e shtymë nga dita e djeshme. Faleminderit!

**Vendimi nr.10**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kokoshi*

P. *Dilekçay*